

NAMIK DOKLE
ZHDUKJA E ÇMIMIT NOBEL
ROMAN

BOTIMET TOENA

NAMIK DOKLE

ZHDUKJA
E ÇMIMIT NOBEL

roman

BOTIMET TOENA

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi

Redaktor letrar: Eris Rusi

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Erdita Oshafi

ISBN 9789928960733

© AUTORI *dhe* BOTIMET TOENA

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. “M. Gjollësja”, nr. 71, Tiranë 1023

ose K. Postare 1420

Tel.: +355 67 70 70 884

botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

Dy lajme tronditëse

Një mëngjes të ftohtë marsi, në ditën e njëmbëdhjetë të atij muaji që nuk është as dimër, as pranverë, në Prokurorinë e Shtetit erdhën, njëherësh, dy njoftime nga qyteti me emrin e çuditshëm Meslumas, dhe të dy për zhdukje, që, me sa shihej nga ekspertët, nuk besohej të kishin lidhje me njëra-tjetrën. Lajmi i parë ishte tronditës; dy fëmijë, një vajzë dhe një djalë të moshës dymbëdhjetë dhe katërmbëdhjetë vjeç, ishin zhdukur dhe askush nuk kishte parë a dëgjuar për ndonjë gjurmë të tyre; as familja, as fqinjët, as moshatarët e tyre.

- Ti je nga ato anë, mbase ke ndonjë ide, - iu drejtua Kryeprokurorja të vetmit që ishte nga Meslumasi.

- Nuk kam asnjë ide, sepse atje, kurrë nuk ka ndodhur ndonjë rrëmbim fëmijësh, as në vitin nëntëdhjetë e shtatë, kur rrëmbimi i vajzave ishte bërë si vjedhja e kastravecëve në kopshtin e fqinjit, - tha ai.

- Nuk hoqe dorë nga këto krahasime gazetareske, - tha shefja.

- Sëmundje profesionale, - e nxori nga situata njëri nga kolegët, i cili e dinte se ai kishte punuar për disa

kohë në një radio përpara se të kalonte në shërbimin e luftës kundër krimit. Kishte botuar edhe një libër me poezi, por askush nuk e mbante mend, as ai vetë.

Akoma më i papritur, madje i padëgjuar ndonjëherë, jo vetëm në qytetin mes dy lumenjve, por as në gjithë vendin, madje as në gjithë planetin, ishte lajmi i dytë. Po atë ditë që ishin zhdukur dy fëmijët, ishte zhdukur edhe *Çmimi Nobel i Paqes*, të cilin ai qytet e kishte fituar disa muaj më parë. Dhe ky, që për momentin dukej thjesht një lajm i çuditshëm, brenda bërthamës së vet ruante një fuqi shpërthyesë që mund të trondiste botën, ose të paktën atë pjesë të saj që e dinte se çfarë ishte ai çmim botëror që pritej me frymën pezull nga miliona njerëz.

- Dy zhdukjet janë si dy sorra që ulen njëherësh në borë dhe mund të shkaktojnë një ortek shkatërrues, - tha prokurori me fillesë në gazetari dhe u pendua menjëherë, me drojën se ndonjëri prej kolegëve do të fliste me tallje për atë sëmundjen e tij profesionale që çdo gjë që përflitej ta krahasonte me diçka tjetër që dihej, apo ta mbështillte me citate dhe proverba. Por ndoshta nga ndjesia e tmerrit që shkaktonte fjala ortek, asnjëri prej tyre nuk foli.

- E po, atëherë? - këmbënguli shefja.

Të gjithë ngritën supet.

- Ti duhet të nisesh menjëherë! - urdhëroi. - Ti ke lindur dhe je rritur në atë qytet, i njeh dhe të njohin njerëzit dhe, - u hodhi një sy të tjerëve si për të kërkuar miratim për çka po thoshte, - kjo rrethanë mund ta

lehtësojë punën. Më vonë ndoshta të dërgojmë edhe ndonjë përforcim.

Ai nuk foli, por iu duk vetja në boshllëk, as në qiell, as në tokë. Ajo çka kryeprokurorja e mendonte si lehtësi, për atë ishte gjëja më e vështirë, e kishte shumë bezdi të merrte në pyetje njerëzit, të cilët dikur, në kohë e rrethana të ndryshme, i kishte njohur, kishte pasur miqësi apo inate me ata, me disa kishte pirë birrë në pushimet mes emisioneve të radios, me ndonjë ishte grindur, disa ishin në rrathët e tij të shumtë fisnorë, të tjerë në armiqësi dhe urrejtje me fisin e tyre për një mijë e një gjëra të ndodhura e të pandodhura, për biografi, për prishje krushqish, për një sharje të kthyer në sherr, për një gardh e për një mur që ndante pronat e atij që i kishte me tjetrin që donte t'ia merrte. Vetëm për *Çmimin Nobel* nuk ishin grindur deri sot, ja ku erdhi edhe ai që të ngatërroheshin edhe më keq. *Zogu glason kudo, por jo në çerdhe të vet*, kujtoi një nga aforizmat e shumta që i kishte në majë të gjuhës.

Ujin e mullimendjes ia preu njëri nga kolegët që e ftoi në zyrë, duke i thënë se kishte diçka që mund ta ndihmonte.

- Është kjo letra, - i tha, - anonime por... nuk e vlerësova pikërisht ngaqë ishte pa emrin e dërguesit. Madje e mora për tallje të ndonjë trillani; kujt i shkon në mend të rrëmbejë apo të zhdukë *Çmimin Nobel*? Asgjëkund nuk ka ndodhur. Kurrë! Ka pasur refuzime të çmimit, por jo zhdukje. As rrëmbime.

- E di njeri tjetër?

- Jo, të thashë, nuk e mora seriozisht...

- Harrove që në këtë mut pune që kemi, ferra e vogël nxjerr lepurin e madh?

- Lëri aman ato krahasimet, më thuaj ç'do të bësh me këtë letrën?

- Asgjë, do ta mbaj, - dhe ia mori nga dora. Me një shkrim të rregullt, thujse të bukur, bëhej njoftimi se në qytetin Meslumas nuk dihej tashmë se ku ishte *Çmimi Nobel*. Madje, letërshkruesi anonim, përdorte emrin e vjetër të qytetit, *Mesdylumas*, ngaqë ishte ngritur mes dy lumenjve, emër që më vonë u shkurtua pak e u bë *Meslumas*. Pa datën dhe llogaritë që letra ishte shkruar katër ditë më parë. Ndërkohë lajmi i zhdukjes së vërtetë të çmimit kishte ardhur atë mëngjes. Ra në zgrip të arsytimit profesional dhe nuk po e kapte dot fillin, i dukej si tymi i cigares; kur ngre dorën të kapësh një shtëllungë, ai përndahet dhe zhduket. U mundua ta lidhte zhdukjen e *Nobelit* me letrën anonime, por në atë imtë i dilnin para syve fytyrat e pafajshme të dy fëmijëve të zhdukur dhe diçka këputej në mes.

- Qetësohu, - i tha kolegut, - për këtë letër dimë vetëm ti dhe unë, askush tjetër. Përndryshe do të na zinte nën vete orteku i telasheve.

Tjetri nuk foli, por në sytë e tij pa një mirënjohje të sigurtë e dashamirëse. I dha dorën dhe u nis të bëhej gati për atë udhëtim dhe hetim të rrallë, që nuk i kishte ndodhur asnjë prokurori të botës. Të paktën deri atë ditë. Duke rregulluar ca letra e dokumente

në çantë dhe pak rroba në një valixhe të vogël, kishte ndjesinë e një bote të huaj, të panjohur më parë. “Më duket se po kllumem në ujë të zi, ca më keq, në ujë balte”, - i tha vetes. Një orë më vonë u nis për në qytetin e tij të lindjes për të cilin, çuditërisht, asaj herë nuk ndiente mall.

Përsiatje seksi

Pasi kishte menduar një mijë e një mënyrat se si dhe nga do ta fillonte hetimin, në kalim të qafës së fundit të maleve drejt qytetit, qepallat ia rëndoi gjumi, një gjumë i rrejshëm që nuk është as i kësaj bote dhe as i tjetrës. Ishte më shumë një zhytje në ditë të shkuara, e butë në dukje, por mbytëse në të vërtetë, si ajo e një kali që ka rënë në një llurbë thithëse. Kur gjithçka rreth e rrotull u shurdhua, ëndrras dëgjoi instruktoren që pyeti:

“Dhe ku bie ai vendi juaj?”.

Kishin shkuar për një kurs specializimi pranë FBI-së, në një qytet të Amerikës dhe ishin një tufë e madhe prokurorësh të rinj nga disa vende të Europës Lindore. Instruktorja ishte aq strikte në zhvillimin e praktikave mësimore sa nuk bënte asnjë pyetje jashtë temave të ditës. “Mëkat, - thoshte një rumun, - se është edhe e bukur, por e din se një bisedë e këndshme e deh gruan më shumë se vera dhe e hedh në krahët e burrit, prandaj nuk na afrohet.” Në ditën e fundit, në koktejin e lamtumirës, siç e quanin, ajo i bëri atë pyetje të papritur që e hutoi një grimëherë.

“Si, ku bie?”

“Ku gjendet pra?”

“Në Lindje.”

“E di që është në Lindje, po me kë fqinjëron?”

Ai deshi t’i tregonte atë legjendën, në të cilën fqinjët e atdheut të tij po i ankoheshin Zotit se atij vendi i kishte dhënë gjithë të mirat; do det? Ke dy dete; do liqen? Ke dhjetëra liqene; do male dhe pyje? Po t’i jap me shumicë; do fushë? Po të jap edhe fusha; do lumenj? Po të jap ca lumenj të mrekullueshëm që ta ndajnë gjithë vendin në hapësira të barabarta dhe të jenë të gjithë me të njëjtin drejtim rrjedhjeje... Por Zoti ua preu: Oh, ashtu është, gjithë të mirat i dhashë, por fqinjët jo!

Megjithatë nuk e tregoi me drojën se mos amerikanja do t’i jepte ndonjë interpretim politik të pavolitshëm. I bëri një përshkrim të përgjithshëm, i sigurt që oficerja amerikane nuk do ta merrte vesh kurrë se ku gjendej atdheu i tij. Kur ajo e pyeti për ndonjë personalitet të njohur nga vendlindja, ai i përmendi një tufë emrash, princa dhe pashallarë, deri tek Aleksandri i Madh, pa harruar as edhe një Papë të Romës.

- Paske fantazi të zhvilluar, - i tha ajo. Ndoshta ngaqë ke punuar si gazetar më përpara...

- Nuk është çështje fantazie por...

- Po më tej?

- Edhe një gjë tjetër që me siguri nuk do ta besoni.

- Pa ta dëgjojmë...

- Një nga shpikësit e viagrës është bashkatdhetari im.

Ajo u përdrodh sikur ta kishte pickuar ndonjë bizerinë.

- Edhe këtë ma thua? Ata janë tre shkencëtarë amerikanë, mor djalë.

- Por njëri është me origjinë nga ne, - tha, duke e zbuluar me plot broçkulla. Por asaj nuk i bëri ndonjë përshtypje ai shpjegim; e shikoi me sy zhbirilues dhe lëshoi pyetjen që e tromaksi, ishte krejt e papritur, si rrufe në qiell të pastër, pas të cilës gjithçka bie në heshtje.

- E përdor viagrën? - pyeti ajo, ndërsa ai sikur ndjeu aromën e ozonit të djegur.

- Jo, e kam përbrenda. - Kur tha këtë fjalë nuk e shikoi në sy dhe ndoshta për këtë arsye vështrimi i tij rrëshqiti tek ai rumuni që kishte thënë ato fjalët profetike... një bisedë e çuditshme... apo e këndshme, e hedh gruan në krahët e burrit më shumë se një shishe verë... a më shumë se një grusht me viagra. Ndërsa po mendonte këto, në atë imtë, ra rrufeja e dytë:

- Do ta provojmë...

Kur tha ato fjalë iu duk edhe më tërheqëse.

Që atë mbrëmje e mori në shtëpinë e saj dhe pasi e kaluan gjithë natën si dy krimba shiu mbi njëri-tjetrin; seks, gjumë... seks, verë dhe përsëri seks, ajo, duke u shkrydhur në gjithë hapësirën e shtratit, i tha

që, tashmë, e besonte se shpikësi i viagrës do të ketë qenë nga vendi i tij.

- Edhe një herë që të mos e harrosh, - tha ai dhe e mori mbi vete, pastaj nën vete dhe ashtu, duke u rrokullisur në gjithë hapësirën e krevatit të madh, ia bëri kockat pluhur.

- Sa e lehtë ndihem, - mëmëriti ajo, - më duket vetja pesë vjet më e re.

- U bërë moshatare me mua, - i tha ai dhe e shtrëngoi butësisht mes krahëve.

Po të kishte qëndruar edhe ndonjë ditë më shumë në atë qytet, ndoshta do të binin në dashuri me njëritjetrit. Këtë e kuptoi në puthjen e fundit, kur ndjeu njëlmesinë e lotëve të saj në buzë. Puthje më të ëmbël nuk kishte provuar. Por... Ky *Nobeli i Meslumasit* ishte krejt ndryshe... Dhe krejt papritur i shkrepri në kokë se dy zhdukjet e asaj dite, në një mënyrë ose tjetër, mund të plekseshin disi mes tyre. Ndoshta rrëmbyesit e çmimit, për të humbur gjurmët, a për të tërhequr vëmendjen në një drejtim të gabuar, kishin bërë njëherësh të dyja grabitjet. Apo e kundërta mund të jetë më e logjikshme; për të fshehur, për të mbuluar zhurmën e grabitjes së fëmijëve, kishin bërë edhe atë lojën e *Çmimit Nobel*. Fundja kujt i duhej ai medaljon që vlente mijëra herë më pak se organet e freskëta të dy adoleshentëve, të cilat, kushedi se ku, në ç'klinikë të botës, i priste ndonjë miliard. Ose nuk kishin asnjë lidhje me njëra-tjetrën këto

dy grabitje, këto dy zhdukje të papritura që po ia troshitnin trurin. Ç'do të kishte thënë e ç'do të kishte menduar instruktorja e tij e FBI-së? Çfarë pjeshke që kishte! Ndjeu se po e merrte malli për të... Ah, ajo do ta fillonte nga gazetatat, nga lajmet. “Aty e keni gropën e zezë nga fillon të vijë era e rëndë e krimit, - do të thoshte. - Ju duhet vetëm nuhatja që të mos ngatërroni aromat, mos të ngatërroni vrimat nga vjen ajo erë, por duhet ta shikoni nga të gjitha drejtimet. Vetëm ashtu panorama e krimit bëhet e plotë.”

“Edhe gruaja, - i pat thënë ai atë natë, - duhet shijuar nga të gjitha drejtimet...”

“Aj, aj, kush t'i ka mësuar gjithë këto gjëra?” - ia kish kthyer ajo, duke u laguritur me lëkurën e tij të bronzte.

“Lindim të mësuar, - ishte përgjigjja e tij. - Nuk kemi nevojë për kamasutrën indiane.”

Ajo pat shpërthyer në gaz dhe, pas gajasjes, nisi kafshimet përkëdhelëse në vende që vetëm ajo i dinte dhe që ishin më nxitëse edhe nga viagrat e *Çmimit Nobel*.

Hej, dreq! Në vend që të mendoj për Nobelin, po llapërçitem me fituesin e tij viagror... Por mezi e hoqi nga labirinthe e trurit të vet atë peizazh femëror, të bardhë e të lëmuar, me një push thuajse të padukshëm, me ato harkimet marramendëse të gjoksit e të vitheve... Pat ndier dëshirën që të bëhej insekt dhe të qëndronte në brendësinë e kurmit të saj...

Makina po kalonte mbi urën e madhe të njërës prej lumenjve që i kishte dhënë emrin qytetit.

- Mesdylumas, - mendoj Prokurori, - tash u bë edhe Mesdizhdukjesh.

Kur ka tërmet, kambanat bien vetë

Skulptori i qytetit ishte i fundit ose ndër të fundit në qytetin mes dy lumenjve, që e mori vesh lajmin për zhdukjen e djalit të vet, bashkë me një bashkëmoshataren e tij. Të paktën kështu e pëshpëriste këtë lajm i gjithë Meslumasi. Ai njihej për pak hutaq e trullan, por jo deri në atë majë sa të mos dinte për të birin atë që dinte gjithë qyteti, lagjet, rrugët dhe rrugicat e tij. Të gjithë e panë gruan e tij duke vrapuar nëpër trotuare, me rroba shtëpie dhe shapka dhe me një vajulurimë tronditëse, duke kërkuar djalin. Kërkonte dhe nuk dinte ku të kërkonte. Këmbët e çuan te studioja e të shoqit, një ish-magazinë e qilimave të artizanatit, por e gjeti të mbyllur portën e llamarintë, trokiti me grushte, cokati me gurë, por asnjë zë nuk u dëgjua nga brenda. Tronditja e madhe ia kishte shuk zanin dhe nuk pati fuqi të thërriste, por vetëm i binte derës. Kur nuk dëgjoi asnjë përgjigje nga brenda, mbeti kërcik te dera.

Po të kishte bërëtitur, me siguri që burri i saj, skulptori më i dëgjuar i atij qyteti, do ta kishte hapur derën, sepse ai ishte brenda në studio. Kishte vendosur të punonte gjithë atë ditë pa pushuar, edhe drekën e

kishte marrë me vete, sepse ishte shumë mbrapa me krijimin e një basorelievi, më saktë të një triptiku për luftën, për ardhjen e mijëra të përzhënëve në qytetin e tyre dhe për mikpritjen që u bë legjendë dhe i siguroi qytetit *Çmimin Nobel të Paqes*. Por nënës së shkretë nuk i kishte mbetur asnjë cicërimë zëri, kordat e saj ishin shkrehur nga dhimbja dhe tronditja, ndërsa këmbët shkelnin mbi gërmadhat e shpirtit të një nëne që digjej nga parandjenja të frikshme për djalin e vetëm. Nuk thonë kot, kurrë mos i ndodhtë një fëmije ajo çka përfytyron meraku i nënës së tij.

Kur u mor vesh që skulptori nuk gjendej as në qiell as në tokë, as në lumë dhe as në pikëllimë, njerëzit hamendësuan se mos ai ishte turrur kushedi se ku në kërkim të djalit, ndonjëri thoshte se do të ketë shkuar te disa miq të tij në fshat, të tjerë thanë që e kishin parë të hipte në furgonin e kryeqytetit, gjë që vërtetë kishte ndodhur, por dy ose tri ditë më parë; të tjerë shtonin se mund të ketë shkuar të zinte peshk ngaqë shpesh e kishin parë të rrinte me orë të tëra në breg të lumit, aq sa mendonin se ai po fliste me ujërat e tij dhe as që i shkonte mendja te peshqit; nga të gjithë hamendësuesit vetëm njëri prej tyre pëshpëriti se skulptori me siguri ishte në studio, por nuk e hapte derën se bënte dashuri aty brenda me një... me një... që ai nuk guxonte ta thoshte, me prefekten, zonjën Marga, e tha më në fund, por ajo hamendje ra ndonjë orë më vonë, kur vetë prefektja u pa e alarmuar dhe të alarmonte të tjerët, ndërkohë që skulptori ende nuk

ishite gjetur. Më optimistët hamendësuan se ai do të kishte shkuar me të birin në piknik dhe gjithçka ishte një alarm i rremë i së shoqes apo i një gazetari që kishte pasur zakon të hidhte në qytet lajme kësodore. “Duhet zgjuar nga gjumi letargjik ky qytet, - thoshte ai. - Kur nuk ka ngjarje, ato duhen sajuar. Një qytet pa lajme, është një qytet i vdekur.”

Por kjo shkëndijëz optimizmi u shua shumë shpejt ngaqë nëna e vajzës, një skenariste e njohur e qytetit, ishte nga të parat që e mori vesh lajmin. Për më tepër, nga shumë njoftime të njerëzve që shkonin në komisariatit e policisë, njëri thoshte se i kishte parë dy fëmijët tek agjencia e furgonëve, madje vajzën e skenaristes, tha që e njohte dhe kishte një çantë të vogël në dorë. Njoftimi i tij ishte qetësues, por kur ai shtoi se i qenë dukur paksa të trembur dhe si të hutuar, gjithçka u kthye përmbys. Pse të ishin të trembur? Dikush i kishte kërcënuar për diçka apo kishin parë aty rrotull ndonjë nga ata të fortët, siç quheshin, dhe mund të të bënin gjëmën edhe në mes të ditës, apo kishin marrë vesh ndonjë të vërtetë të rrezikshme, duke u ndodhur në kohën e gabuar dhe në vendin e gabuar...

Aty nga mesdita, prokurori i kryeqendrës së vendit mbërriti në qytet dhe të parin njeri që kërkoi të takonte ishte prefekti.

- Zonja Marga është në kërkim të skulptorit, - i thanë.

- Pse qenka zhdukur edhe ndonjë skulptor? - pyeti ai i alarmuar.

- Jo, jo, djali i tij, por edhe skulptori nuk është parë nëpër qytet.

Kur prefektja ishte nisur për te studioja e skulptorit, dikush i tha se atje nuk mund ta gjente, se gruaja e tij gati sa nuk e kishte shqyer derën, por askush nuk qe përgjigjur nga brenda.

- Lëre atë shushkë në hallin e vet, - tha ajo dhe vazhdoi rrugën. Cokati te porta tri herë radhazi dhe një të katërt me shkëputje, siç kishte bërë edhe disa herë më parë, kur shkonte, siç thosh, për të kontrolluar se si po ecte puna me përkujtimoren (nuk e thoshte fjalën basoreliev se i dukej si lesh xhami në gojë) për luftën dhe madhësitinë e mikpritjes së popullit të qarkut në të cilin ajo kishte nderin të ishte njeriu i parë. Sapo hapi derën dhe pa Margën, skulptori i tha nxitimthi:

- Të lutem, sot jo, jam shumë mbrapa me triptikun.
- Ai i kishte duart të llangosura me argjilë, stërpikat e së cilës i kishin rënë edhe në rroba e në fytyrë. Zonja Marga vuri re një grimë argjile në vetullën e majtë dhe iu duk si një lyth dore që kishte kërcyer deri te balli i skulptorit. Pa dorën e saj dhe vuri re që lythi ishte aty, ku kishte dalë që dhjetë vjet më parë dhe ajo e mallkonte çdo ditë, edhe dy herë në ditë, por kurrë nuk kishte guxuar ta hiqte.

- Çfarë thua, mor idiot kolerik! - i bërtiti ajo me një ton zyrtar, si për t'i bërë parapritë për lajmin tronditës që do t'i jepte. Nuk po kujtohej se nga cili libër e kishte huazuar atë *idiot kolerik*, megjithatë, kur ia tha lajmin e zhdukjes së djalit, ai u drodh

dhe u nis me vrap drejt shtëpisë, pa u pastruar nga argjila, pa hequr përparësen gri me të cilën punonte. “I shkreti, i ka ra mali mbi krye!”, thoshin njerëzit, kur e shikonin. “Kur ka tërmet, kambanat bien vetë”, shtonin të tjerë, më tutje. Nuk e ndaloj askush, por edhe ai nuk u ndal të pyeste ndokënd për djalin apo për ndonjë gjë tjetër. Në shtëpi gjeti gërmadhën e një nëne fëmihumbur, të cilën nuk mund ta ngushëllonte asnjë fjalë e kësaj bote. Dhe ai nuk e hapi gojën, por qëndroi ashtu i ngrirë, si ato statujat e studios së tij. Vetëm i foli vetes dhe ndjeu shkërmoqjen përbrenda. “Jam një statujë e vdekur, jam një baba i dhjerë! Jam një *idiot kolerik* dhe një skulptor muti!” U ul pranë gruas dhe qëndroi ashtu për një kohë të gjatë, ndoshta një shekull, mendoi. Lëvizi vetëm kur e lajmëruan se kishte ardhur një prokuror dhe e priste për të biseduar me të.

- Me siguri ka ardhur për djalin, - i tha gruas si për të shpjeguar largimin e tij nga shtëpia. E dinte se në gjithë jetën e tij, gjëja që më shumë e kishte shkapërdredhur bashkëjetesën e tyre, ishte prania e tij e paktë në jetën e familjes. Rrogën e dorëzonte rregullisht, por për asgjë tjetër më nuk pyeste. Hante kur mund të hante, pinte kur donte të pinte, vishte këmishë të larë, kur ishte e larë, mbathte këpucët e lustruara që i gjente te dera çdo mëngjes, madje as çelës shtëpie nuk mbante me vete; e dinte se do ta gjente gjithnjë të hapur dhe do të dëgjonte, për të njëmiliontën herë, vetëm një pyetje: a erdhe? Dhe